



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 39, datë 09. 10. 2012

**PËR
“EMËRIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË KLUBIT TË FUTBOLLIT TIRANA
SHA”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8/1/I”b”, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), nenit 135 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 për “Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” (i ndryshuar), nenit 42 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 për “Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar), vendimit nr. 14, datë 12.10.2011 për “Transformimin në shoqëri Aksionare “Klubi i Futbollit Tirana”, miratimin e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë Aksionare “Klubi i Futbollit Tirana”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Emërimin e ekspertëve kontabël Z. Lulash Pjetërnikaj me nr.license 109, datë 21.12.2000 dhe Z. Altin Ngjela me nr. License 157, datë 19.05.2006 për auditimin e bilancit vjetor dhe detyra të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për Klubin e Futbollit Tirana sha.
2. Ngarkohet administratori i dytë i Klubit të Futbollit Tirana sha z. Salih Tagani, të bëjë rregjistrimin e vendimit për emërimin e ekspertëve kontabël pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
3. Ngarkohet “Klubi i Futbollit Tirana” sha., për zbatim e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI